

Akti i Themelimit
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Lyhnid” SHPK

Datë , 15. 01. 2024

Me cilesine e “ortakëve themelues;

Genti Tola , lindur më datë 11.08.1989, pajisur me ID nr. I90811104T, Vaso Naço , lindur me datë 27.05.1990, pajisur me ID nr. J00527088D, Erlis Turshinka , lindur me datë 27.05.1990, pajisur me ID nr. J00527087S, Llambi Turshinka, lindur me datë 25.12.1962, pajisur me ID nr. G21225048D, Violleca Turshinka, lindur me datë 25.12.1967, pajisur me ID nr. G76225175V. Mbeshtetur në legjislacionin shqiptar ne pergjithesi dhe ne vecanti ne ligjin 9901, date 14.04.2008, “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “, i ndryshuar, dhe ne Ligjin Nr. 9723 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, hartojme statutin e shoqerise **“Lyhnid” SHPK.**

KREUI

Neni 1

Krijimi

Shoqeria **“Lyhnid” SHPK** eshte person juridik i të drejtes shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi të Kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).


Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“Lyhnid” shpk** , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Genti Tola , lindur më datë 11.08.1989, pajisur me ID nr. I90811104T, Vaso Naço , lindur me datë 27.05.1990, pajisur me ID nr. J00527088D, Erlis Turshinka , lindur me datë 27.05.1990, pajisur me ID nr. J00527087S, Llambi Turshinka, lindur me datë 25.12.1962, pajisur me ID nr. G21225048D, Violleca Turshinka, lindur me datë 25.12.1967, pajisur me ID nr. G76225175V, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e kontributeve të nënshkruara.

Emri tregtar i shoqerise do te jete **“Lyhnid”**



Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne : " Korce Pogradec TUSHEMISHT Fshati Tushemisht, ZK 3664, banese private tek ish rritja e peshkut, kati 1".

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Kjo shoqeri do te ushtroje aktivitetin e saj ne:

Perpunim dhe prodhim vere Sherbime turistike; hoteleri; Restorant dhe bar;

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore : Pa afat.

KREU II

KAPITALI

Neni 6


Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 5,402,160 njeqind mije lekë..

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga ortakët e shoqerise :

Genti Tola lindur më datë 11.08.1989, pajisur me ID nr. I90811104T zoteron 1 kuote me vlere 1,800,720 lek, qe perben 33.3 % të kapitalit të shoqërisë. Vaso Naço lindur me datë 27.05.1990, pajisur me ID nr. J00527088D zoteron 1 kuote me vlere 1,800,720 lek, që perben 33.3 % të kapitalit të shoqërisë. Erlis Turshinka lindur me datë 27.05.1990, pajisur me ID nr. J00527087S zoteron 1 kuote me vlere 424,969.92 lek, qe perben 7.85 % të kapitalit të shoqërisë. Llambi Turshinka, lindur me datë 25.12.1962, pajisur me ID nr. G21225048D zoteron 1 kuote me vlere 950,780.16 lek, që perben 17.6 % të kapitalit të shoqërisë. Violca Turshinka, lindur me datë 25.12.1967, pajisur me ID nr. G76225175V zoteron 1 kuote me vlere 424,969.92 lek, qe perben 7.85 % të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali qe kontribuojne Erlis Turshinka, Llambi Turshinka dhe Violca Turshinka do te jete në natyre, sipërfaqe toke ndertimi 1098 m2 e perbere nga dy prona te cilat se bashku perbejne vleren 1,800,720 leke sipas roport vleresimeve te ekspertit date 04.01.2024 (Toke truall me sip. 777m2 me Numer Pasurie 10/6 Zona Kadastrale 3664 e zoteruar nga Erlis Turshinka, Llambi Turshinka



dhe Violca Turshinka) e konvertura ne vleren monetare 1,274,280 lek. Si edhe (Toke truall me sip. 321m2 me Numer Pasurie 10/7 Zona Kadastrale 3664 e zoteruar nga Llambi Turshinka) e konvertur ne vleren monetare 526,440 lek.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8


Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;



- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë është **Vaso Naço** me ID nr. J00527088D, emeruar në këto detyra për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatitë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetem edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar


Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto raste Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të



shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14


Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 6 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike. Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare **Lyhnid SHPK** , nenshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmat orgjinale te secilit.


ORTAKU
Genti Tola




ORTAKU
Vaso Naço



ORTAKU
Erlis Turshinka



ORTAKU
Llambi Turshinka



ORTAKU
Violca Turshinka

